



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 284, Datë 06.11.2025

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“ELENERGJI” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2725/1 prot., datë 03.11.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “ELENERGJI” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “ELENERGJI” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2725 prot., datë 27.10.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Bushtica 1”, me kapacitet të instaluar 5,226 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë, në Qarkun e Elbasanit.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas gërmave a, b dhe c, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas Aneksit A.
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas gërmave a, b dhe d.
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas gërmës c.
- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas gërmave b, c dhe f.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

- Shoqëria është pajisur me Kontratën e Koncesionit të formës “BOT” (Ndërtim-Operim-Transferim) “Për ndërtimin e Hidrocentralit “Bushtrica 1”, datë 18.09.2017, nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Subjektit për qëllime të veçanta “ELENERGJI” sh.p.k.. Kjo kontratë është ndryshuar respektivisht me Kontratën shtesë të koncesionit të datës 06.01.2022 dhe Kontratën shtesë të koncesionit të datës 17.01.2025.
- Shoqëria ka nënshkruar “Marrëveshjen për Lidhjen me Rrjetin e Transmetimit, të datës 15.08.2018, me OST sh.a., për lidhjen e hidrocentralit me rrjetin e transmetimit. Kjo Marrëveshje është ndryshuar në datën 28.07.2025.
- Shoqëria është pajisur me lejen për përdorimin e burimit ujor sipërfaqësor të datës 31.05.2022, lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor (KBU) Shkumbin.
- Shoqëria është pajisur me Deklaratë Mjedisore, datë 25.03.2024, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për Personin Juridik “ELENERGJI” sh.p.k., për të zhvilluar projektin: “HEC Bushtrica 1”.
- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- Shoqëria të depozitojë informacion në lidhje me stafin teknik efektiv që ka aktualisht funksional në strukturën e saj. **(gërma “c”)**

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin që nuk ka detyrime të paslyera në lidhje me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. **(gërma “a”)**
- Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin mbështetës financiar për realizmin e plotë të projektit, pasi rezulton se nuk ka depozituar asnjë dokument. **(gërma “b”)**

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- Shoqëria duhet të bëjë sqarimet përkatëse në shtojcën 2, në lidhje me datën e operimit, që duhet të përkohet me kontratën me MIE-n dhe datën e fillimit të punimeve, që duhet të përkohet me vlefshmërinë e VNM-së Paraprake. **(gërma “a”)**
- Shoqëria duhet të depozitojë vendimin e KBU Shkumbin, me anë të të cilit është miratuar Leja e përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor. **(gërma “d”)**
- Shoqëria duhet të japë sqarimet përkatëse në lidhje me kapacitetin e instaluar të përcaktuar në Deklaratën Mjedisore. **(gërma “e”)**
- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Po ashtu, në nenin 5, pika 2 të Rregullores së sipërcituar, parashikohet se për aplikimet në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të cilat paraqiten në ERE më vonë se data efektive e kontratës/autorizimit, llogaritja e afatit të licencimit, bëhet për periudhën e mbetur.

- Kontrata e Koncesionit, e ndryshuar, ka një afat 35-vjeçar dhe konstatohet se shoqëria ka humbur afërsisht 8 vjet dhe 1 muaj nga periudha koncensionare dhe periudha e mbetur për licencim është afërsisht 26 vjet e 11 muaj. Gjithsesi, në rast licencimi të shoqërisë, në fazën përfundimtare do të bëhet përllogaritja e afateve që i mbeten nga periudha koncensionare, në referencë të të cilit do të jetë dhe afati i licencës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ELENERGJI” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Bushtrica 1”, me kapacitet të instaluar 5,226 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Bushtricë në Qarkun e Elbasanit.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “ELENERGJI” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI